Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**11.08.2023**	**12.08.2023**	**2023/0562**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë: 10.08.2023, Operatori Ekonomik (OE) "Muharrem Hoti B.I."- Malishevë, ka parashtruar ankesë me numër: 2023/0562, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE-ve "Smart Projekt SH.P.K.; Hidro Project SH.P.K.; Grand Bau SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIMI DHE MIRËMBAJTJA ME MATERIAL TEKNIK PËR NEVOJAT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË KOMUNEN E MALISHEVËS", me numë të prokurimit: "62500-23-3176-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malishevë. AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 135,055.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 1 i LPP-se
- Neni 6 i LPP-se
- Neni 7 i LPP-se
- Neni 56 i LPP-se
- Neni 59 i LPP-se
- Neni 60 i LPP-se
- Neni 64 i LPP-se
- Neni 68 i LPP-se

- Neni 69 i LPP-se
- Neni 72 i LPP-se
- Neni 25 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
- Neni 26 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
- Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
- Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
- Neni 8 i Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim publik

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Data e njoftimit për kontrate është bere me dt.05.04.2023, kurse hapja e ofertave është bere me dt. 16.05.2023 ku kane ofertuar katër operator ekonomik. Njoftimi mbi vendimin e AK-se është bere me dt. 04.08.2023 ku është rekomanduar për kontrate grupi i OE Smart Projekt SHPK&Hidro Project SHPK&GrandBau SHPK me çmim prej: 112,655.00 €, ndërsa neve na është dërguar letra standarde per tenderues te eliminuar me arsyetimin se: "Ne disa pozicione kemi ofruar çmim jo normalisht te ulet dhe pas sqarimeve nuk është bind autoriteti kontraktues dhe se janë plotësuar te tri kushtet sipas nenit 41 paragrafi 41.3 pikat i, ii, iii te Rregullores për prokurim Publik".

Ne lidhje me ofertën tone, ne me dt.29.05.2023 kemi pranuar letrën standarde te kërkesës për informata mbi tenderët jo normalisht te ulet konkretisht për te sqaruar çmimet për pozicionet, 51, 56, 59, 60, 70, 89, 90,149. Ne lidhje me këtë kërkesë ne kemi kthyer përgjigje ku kemi konfirmuar dhe garantuar se ju qëndrojmë ne tërësi te gjitha çmimeve te dhëna ne këtë tender e po ashtu edhe çmimeve për pozicionet te cilat janë kërkuar sqarime. Po ashtu kemi dhënë garancion se mund ta kryejmë kontratën me çmimet e ofruara dhe sipas specifikimit teknik. Autoriteti kontraktues nuk ka marr parasysh sqarimin dhe arsyetimin e kompanisë tone dhe na ka eliminuar me arsyetimin e lartpërmendur. Sa i përket arsyes se eliminimit, ju sqarojmë se edhe tani qëndrojmë ne tërësi pranë te gjitha çmimeve te ofruara ne këtë tender dhe zotohemi plotësisht qe mund ta përfundojmë kontratën. Gjithashtu, ne kërkesë për rishqyrtim e edhe tani e konfirmojmë se jemi ne gjendje ta pranojmë një rritje te sigurimit te ekzekutimit te kontratës për aq sa AK-ja e sheh te arsyeshme me qellim te garantimit te ekzekutimit te kontratës. Madje jemi ne gjendje te deponojmë sigurim te ekzekutimit edhe ne vlerën prej 30,000.00 Euro. Sa për rikujtim, ne kemi përfunduar edhe kontratën e kaluar pa asnjë problem dhe me shume përgjegjësi, prandaj edhe ky fakt është një dëshmi konkrete se ne jemi te përgjegjshëm ne krye1jen e punëve te kontraktuara. Ne këtë rast nuk është respektuar neni 61 i LPP-se dhe neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik. Ne kemi kërkuar qasje ne dokumentacion dhe kemi marr qasje te plote, dhe ne raport te vlerësimit te dt.19.06.2023 kemi vërejt se komisioni i vlerësimit ne perbe1je prej tre anëtarëve kane rekomanduar qe fitues te shpallet kompania jonë Muharrem Hoti B.I & NTSH Delfina. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk ka aprovuar rekomandimin komisionit vlerësues por ka konsideruar se oferta jone është me çmim jo normalisht të ulët. Pas këtij veprimi është përgatitur raporti i rivlerësimit i dt.03.08.2023 dhe ne këtë raport figuron se nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit është rekomanduar për kontrate grupi i OE Smart Projekt SHPK&Hidro Project SHPK&GrandBau SHPK me çmim

prej:112,655.00 €, por qe ky raport nuk është i nënshkruar nga komisioni vlerësues i ofertave.

Pra, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me veprimin e tij ka rrezikuar dëmtimin e buxhetit ne shumen prej 46,472.00 € aq sa është diferenca e çmimit tone ne raport me grupin e operatoreve ekonomik te rekomanduar për kontrate Gjate analizimit te dokumentacionit te OE te rekomanduar për kontrate kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet qe do ti elaborojme me poshtë. Grupi i OE te rekomanduar për kontrate "SMART PROJEKT HIDROPROJECT GRANDBAU SHPK kane vendos çmime manipulative, prandaj duhet eliminuar automatikisht nga konkurrenca. Me poshtë po i cekim disa nga pozicionet qe janë ofrua çmime manipulative dhe jo ne harmoni me çmimet e tregut

Furnizimi, montimi dhe mirembajtja e Sklopkave hidroforit {automatik)	copë	20	200

Ndërsa çmimi real i tregut për shitje dhe montim është 5 Euro për cope

Shkuma qe nuk fryhet	copë	40	1

Ndërsa çmimi real i tregut për shitje është 4.50 Euro për cope

Shkum pa presjon	copë	100	2

Ndërsa çmimi real i tregut për shitje është 4.50 Euro për cope

Nitne 2.5 cm {1000 copa)	copë	240	1

Ndërsa çmimi real i tregut për shitje është 5.00 Euro për Pako

Plloqa te fleksit te madh	copë	100	1

Ndërsa çmimi real i tregut për shitje është 3.30 Euro për cope

KORREKTOR 1000 W	Copë	8	30

Ndërsa çmimi real i tregut për shitje është 220 Euro për cope

Nga sqarimet qe u bene ma lartë, kuptohet qarte qe grupi i OE te rekomanduar për kontrate ka ofruar çmime manipulative dhe çmime jo ne harmoni me çmimet e tregut, ndërsa AK-ja ne këtë rast ka përdor standarde te dyfishta sepse nga ne ka kërkuar sqarime për çmime jo normalisht te ulëta, madje na ka eliminuar me një arsyetim te tille, kurse nga grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk ka kërkuar asnjë sqarime ne lidhje me këto çmime, e te cilat janë, manipulative dhe që mund ta dëmtojnë buxhetin mjaft shume.

Grupi i OE te rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofru dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrate ne vlere prej 200,000.00Euro. (dyqind mije euro).

Ne nenin 9.1&9.2 te FDT-se është kërkuar si në vijim: *1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë ne vlere prej 200,000.00Euro. (dyqindemijeeuro).*

Kurse dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar: *a)Lista e kontratave - origjinal te natyrës se ngjashme ne 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate te bashkangjitura me kopjet proceseve, raporteve te pranimeve , referenca apo te ngjashme, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj.) ose proceset e pranimeve nga OE privat, me kusht qe pagesat te janë kryer nëpërmes institucioneve bankare.*

Grupi i Operatoreve Ekonomik te rekomanduar për kontrate ka prezantuar referenca dhe kontrata te furnizimeve me armature dhe materiale ndërtimore, ndërsa ky tender ka te beje me materiale te mirëmbajtjes materiale te teknikes se bardhe materiale te sanitarisë materiale te hidrosanitare e jo me materiale te bllokave apo armaturave. Duke pasur parasysh kërkesën dhe dëshmitë e ofruara nga ky grup atëherë rezulton se nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur. Referencat e prezantuara nga kompanitë private nuk janë te dëshmuara edhe me kontrata, por janë vetëm faturat e dorëzuara dhe te pranuara, prandaj nga këto te dhëna nuk mund te kuptohet se çka është dorëzuar apo pranuar. Operatori ekonomik Grandbau ka dorëzuar vetëm faturat e shitjes dhe asnjë reference te pranuar nga ana e blerëseve, prandaj këto dëshmi janë jo te vlefshme dhe jo te pranueshme dhe nuk janë sipas kërkesës se FDT-se. Kontratat si ne vijim:

Furnizim me material ndërtimor dhe hekrari Lot 1

Furnizimi me material ndërtimore

Janë kontrata që nuk kane te bëjnë me natyrën e këtij aktiviteti te prokurimit dhe nuk mund te

merren qe janë ne harmoni me kërkesën, sepse këto kontrata nuk janë as te ngjashme me natyrën e këtij aktiviteti te prokurimit. Disa prej kontratave kane te bëjnë vetëm me armatura.

Mund te vërtetohet se me referenca te ngjashme arrihet vlera vetëm prej 57,168.56 Euro sipas kërkesave te FTD-se, ndërsa dëshmitë e tjera nuk janë sipas kërkesave te FTD-se Me poshtë i keni te bashkangjitura kontrate te cilat realisht nuk kane te bëjnë me kërkesën e FDT-se dhe nuk janë as për se afërmi te ngjashme me kërkesën e FDT-se, e leje mete njëjta.

KEDS

Kontratë për Furnizim me Material për mirëmbajtje Lot 2
KEDS & GRAND BAU

KONTRATË

Kjo kontratë është lidhur me datë 13.10.2022 në mes:

Kompania Kosovare Për Distribuim Dhe Furnizim Me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS J.S.C), një kompani e inkorporuar në mënyrë të regullt sipas ligjeve të Kosovës me numër unik **810799364** me nr tvsh- së **330169905,** zyra e regjistruar e të cilës është në Bulevardin Bill Klinton, nr.3, ndërtesa e elektrokosovës, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues" ose "KEDS")

në njërën anë; dhe

Grand Bau Sh.P.K. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e inkorporuar sipas ligjeve të Kosovës me nr. unik **811160308** dhe nr. të TVSh-së **330329450,** zyra e regjistruar e së cilës është adresën Hajvali, p.n., Prishtinë, Republika e Kosovës (në vazhdim "Operatori Ekonomik" ose "Furnizuesi"), me anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate për:

Titulli: Furnizim me Material për mirëmbajtje Lot 2 me numër identifikues **RFQ 57/02-2022 REV04.**

1. Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Furnizim me Material për mirëmbajtje Lot 2.
1.2 Kontrata hyn në fuqi me 13.10.2022 dhe përfundon me dorëzimin e mallrave dhe pagesën e fundit nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 1 paragrafi 3 të kësaj kontrate.
1.3 Afati kohor i përformancës do të jetë 15 ditë nga data e marrjes së mëlhënesës nga Autoriteti Kontraktues.
1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë KEDS.
1.5 Incoterm i aplikueshëm do të jetë DDP (Delivery Duties Paid). Gjatë dorëzimit të mallit në depo së bashku me fletëdorëzimin duhet të ketë edhe një kopje të porosisë së blerjes.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës **pa TVSh do të jetë 5,643.65 €** (pesëmijë e gjashtëqind e dyzet e tre Euro e gjashtëdhjetë e pesë Euro cent), kurse **me TVSh do të jetë 6,659.51 €** (gjashtëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë Euro e pesëdhjetë e një Euro cent). Derivimi i lejuar nga vlera totale e kontratës është 10%.

Çmimet njësi do të jenë si në vijim:

Nr.	Përshkrimi	Njësia/Sasia	Prodhuesi /Tipi	Çmimi Njësi (Pa TVSH)	Total (pa TVSH)
1	Armaturë Φ12mm	5 copë	Shqipëri	10.00 €	50.00 €
2	Ankera M12x120mm	150 copë	Shqipëri	0.50 €	75.00 €
3	Ankera M16x120mm	150 copë	Turki	0.85 €	127.50 €
4	Hag/lanë për dyer metali	81 copë	Turki	1.80 €	149.40 €
5	Bulona 16x45 [mm] (komplet me dado dhe ndërshtresa)	100 copë	Turki	0.70 €	70.00 €
6	Bulona M12x35mm	100 copë	Turki	0.50 €	50.00 €
7	Dado M16mm	100 copë	Turki	0.50 €	50.00 €
8	Distancues 20 [cm]	100 paka	Turki	15.50 €	1,550.00 €

KEDS

Kontratë për Furnizim me Material për mirëmbajtje Lot 2
KEDS & GRAND BAU

KONTRATË

Kjo kontratë është lidhur me datë 13.10.2022 në mes:

Kompania Kosovare Për Distribuim Dhe Furnizim Me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS J.S.C), një kompani e inkorporuar në mënyrë të regullt sipas ligjeve të Kosovës me numër unik **810799364** me nr tvsh- së **330169905,** zyra e regjistruar e të cilës është në Bulevardin Bill Klinton, nr.3, ndërtesa e elektrokosovës, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues" ose "KEDS")

në njërën anë; dhe

Grand Bau Sh.P.K. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e inkorporuar sipas ligjeve të Kosovës me nr. unik **811160308** dhe nr. të TVSh-së **330329450,** zyra e regjistruar e së cilës është adresën Hajvali, p.n., Prishtinë, Republika e Kosovës (në vazhdim "Operatori Ekonomik" ose "Furnizuesi"), me anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate për:

Titulli: Furnizim me Material për mirëmbajtje Lot 2 me numër identifikues **RFQ 37/02-2022 REV04.**

1. Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Furnizim me Material për mirëmbajtje Lot 2.
1.2 Kontrata hyn në fuqi me13.10.2022 dhe përfundon me dorëzimin e mallrave dhe pagesën e fundit nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 1 paragrafi 3 të kësaj kontrate.
1.3 Afati kohor i përformancës do të jetë 15 ditë nga data e marrjes së mëllhëresës nga Autoriteti Kontraktues.
1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë KEDS.
1.5 Incoterm i aplikueshëm do të jetë DDP (Delivery Duties Paid). Gjatë dorëzimit të mallit në depo së bashku me fletëdorëzimin duhet të ketë edhe një kopje të porosisë së blerjes.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës **pa TVSh do të jetë 5,643.65 €** (pesëmijë e gjashtëqind e dyzet e tre Euro e gjashtëdhjetë e pesë Euro cent), kurse **me TVSh do të jetë 6,659.51 €** (gjashtëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë Euro e pesëdhjetë e një Euro cent). Derivimi i lejuar nga vlera totale e kontratës është 10%.

Çmimet njësi do të jenë si në vijim:

Nr.	Përshkrimi	Njësia/Sasia	Prodhuesi /Tipi	Çmimi Njësi (Pa TVSH)	Total (pa TVSH)
1	Armaturë Φ12mm	5 copë	Shqipëri	10.00 €	50.00 €
2	Ankera M12x120mm	150 copë	Shqipëri	0.50 €	75.00 €
3	Ankera M16x120mm	150 copë	Turki	0.85 €	127.50 €
4	Bujlanë për dyer metali	83 copë	Turki	1.80 €	149.40 €
5	Bulona 16x45 [mm] (komplet me disko dhe nëndisqesa)	100 copë	Turki	0.70 €	70.00 €
6	Bulona M12x35mm	100 copë	Turki	0.50 €	50.00 €
7	Dado M16mm	100 copë	Turki	0.50 €	50.00 €
8	Diturcues 20 [cm]	100 paku	Turki	15.50 €	1,550.00 €

Ne lidhje me referencat e grupit te OE te rekomanduar për kontrate, AK-ja ka kërkuar sqarime për dëshmitë e OE Hidroproject sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se.

AK-ja duke e pa qe grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën ne lidhje me referencat për pune te ngjashme është munduar te nxjerr fitues me çdo kusht këtë grup përmes sqarimeve te kërkuara. Edhe pas sqarimeve kuptohet qarte se edhe OE Hidroproject sikurse edhe anëtarët tjerë te konsorciumit nuk kane arrit te plotësojnë kërkesën e FDT-se ne

lidhje me referenca dhe kontrata te natyrës se ngjashme ne vlerën e kërkuar.

Dëshmitë e ofruara nga Hidro Project me sqarime shtese, përsëri nuk janë te natyrës se kërkuar ne dosje te tenderit, prandaj grupi si tërësi është dashur te eliminohet nga konkurrenca dhe te shpallet i papërgjegjshëm sepse sipas nenit 59.4 te LPP-se për tu konsideruar një tenderues i përgjegjshëm duhet te jete oferta e tij ne përputhje te plate mete gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate, kurse ne këtë rast oferta e grupit te OE te rekomanduar për kontrate nuk është ne përputhje me kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate.

Duke pasur parasysh te gjitha mangësitë dhe te metat e ofertës se grupit te OE te rekomanduar për kontrate rezulton se oferta e tyre është e papërgjegjshme, ndërsa kur duhet te konsiderohet oferta e përgjegjshme është qarte edhe neni 40.6 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, ku përcaktohet si ne vijim: 40.6 Tenderi do te konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Oferta e grupit te OE te rekomanduar për kontrate është e papërgjegjshme ne aspektin administrativ dhe teknik. Dëshmitë e ofruara nga grup dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes se tenderit.

Rekomandimi për kontrate nuk është bere ne harmoni edhe me nenin 56 te LPP-se sepse nuk janë marr për baze kriteret e përzgjedhjes ashtu siç, parashihet ne këtë dispozite. Ligjërisht grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk ka asnjë mundësi te shpërblehet për kontrate pasi qe edhe neni 25 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e parasheh qarte se kur mund te konsiderohet i kualifikuar një Operator ekonomik.

Neni 25.1 Sipas Nenit 56 te LPP, një OE do te konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje ne aktivitet te prokurimit nëse: a. Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe

b. Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.

Po ashtu dispozitat e mëposhtme te Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik përcaktojnë si ne vijim: Neni 25.2 Kërkesat e pranueshmerisë, gjithnjë duhet te përmbushen nga OE.

25.5 Kriteret e përzgjedhjes: a. ne asnjë mënyrë nuk mund te përdoren si kritere te dhënies se kontratës b. nuk mund te kenë peshe te caktuara; c. ato janë kërkesa te vlerësimit Kalon/Nuk

kalon.

Pra ne baze te dëshmive te cekura me larte rezulton qarte se grupi i i OE te rekomanduar për kontrate nuk i ka përmbush kërkesat minimale për kualifikim, prandaj është dashur te shpallet i papërgjegjshëm.

Pra kriteret e përzgjedhjes janë kërkesa te vlerësimit Kalon/Nuk kalon, ndërsa ne këtë rast këto kërkesa nuk janë përmbushur nga grupi i OE te rekomanduar për kontrate dhe oferta e këtij grupi nuk duhet te kaloje me tutje.

Këtë fakt e qartëson edhe Udhëzuesi Nr.001/2023 Për Prokurim Publik ku ne nenin 8.5 përcakton qarte: 8.5 Kriteret e përzgjedhjes: i. ne asnjë mënyrë nuk mund te përdorën si kritere te dhënies se kontratës ii. nuk mund te kenë peshe te caktuara; iii. ato janë kërkesa te vlerësimit Kalon/Nuk kalon:

Njëra ose tjetra

Kërkesat janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë janë ende në konsideratë, ose Kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë do të refuzohen menjëherë

Ne rastin konkret kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderi i grupit te OE te rekomanduar për kontrate është dashur te refuzohet menjëherë.

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim me dt.10 .08 .2023, ndërsa ky vendim nuk është arsyetuar fare por vetëm janë përsëritur arsyet e eliminimit pa dhëne asnjë shpjegim me te hollësishëm. Ne vendimin për refuzim te kërkesës për ri shqyrtim nuk është dhënë asnjë përgjigje ne lidhje me pretendimet tona ankimore ne raport me grupin e OE te rekomanduar për kontrate, prandaj ky fakt na j ep te kuptojmë se te gjitha pretendimet tona ne raport me OE e rekomanduar për kontrate janë te bazuara dhe te qëndrueshme dhe me këtë kuptohet se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, kurse ne jemi ofertues i përgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues me këtë rast ka vepruar ne kundërshtim me nenin 108/ A paragrafi 9 i LPP-se ku shkruan qartë "Refuzimi do te arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, ne përputhje me këtë ligj, parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara, nëse ka ndonjë. Për me tepër autoriteti kontraktues mund te pengoje procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi ne lidhje me gatishmërinë e tij për te tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".

Pra AK-se ne këtë rast nuk ka bere asnjë arsyetim ne lidhje me vendimin e tyre për refuzim te kërkesës për rishqyrtim, prandaj ky fakt përbën shkelje ligjore nga ana e AK-se.

Duke u bazuar ne te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë konstatojmë se

ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, sepse është rekomanduar për kontrate OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës e qe ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim me te ulet siç parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontrate grupi i operatoreve ekonomik te papërgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet te prokurimit nuk e ka respektuar nenin 72 te LPP-se ne mënyrë te drejte, pasi qe ka kërkuar sqarime nga grupi i OE te rekomanduar për kontrate për dëshmi te cilat kane qene te qarta e qe realisht nuk ka pasur arsye ligjore te kërkohen sqarime. Pra neni 72 i LPP-se është përdor ne mënyrë te njëanshme dhe favorizuese. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-se, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FTD-se dhe te njoftimit për kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente".

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe "Gjate udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do te sigurojnë; qe (vi) qe tenderi i zgjedhur te përputhet me te gjitha aspektet përmbajtjesore te kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", kurse grupi i OE te rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, pra është vepruar ne kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Ne këtë rast nuk është marr ne konsiderate as neni 6-ekonomiciteti sepse jemi eliminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim me te ulet, kurse me veprimin e AK-se po rrezikohet te dëmtohet buxheti i Komunës pa asnjë arsye.

Gjate zhvillimit te kësaj procedure nuk është marr ne konsiderate edhe neni 1 i LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove. Duke pasur parasysh te gjitha faktet dhe argumentet qe u ceken me lartë, kërkojmë nga OSHP-ja qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE Muharrem HOTI B.I N.T.SH. DELFINA.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-se (B58) dhe lënda te kthehet ne RIVLERESIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave te behet sipas dispozitave ligjore te LPP-se dhe konform kërkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate përndryshe ne do te detyrohemi te vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje ne instancat tjera me te larta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesa:

1.Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë në vlere prej 200,000.00Euro. (dyqind mijë euro).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a)Lista e kontratave - origjinal të natyrës se ngjashme ne 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë te bashkangjitura me kopjet proceseve, raporteve te pranimeve , referenca apo te ngjashme, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) ose proceset e pranimeve nga OE privat, me kusht qe pagesat te janë kryer nëpërmes institucioneve bankare.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Në platformë është ngarkuar raporti i vlerësimit të tenderëve në formatin word i pa nënshkruar në të cilin shënohet:

Grupi i OE „MUHARREM HOTI B.I" & NTSh DELFINA MALISHEVË në ofertën e tyre kanë ofruar shumë pozicione që kanë çmim shumë të ulët në krahasim me çmimet e ofertave të tjera përgjegjëse. Lidhur me këto çmime i kemi dërguar letër standarde për sqarim te tenderit OE duke u mbështetur ne nenin 61 te LPP. Kam pranuar shkresën e OE e cila sipas pikës se paragrafit 1 te nenit 61 deri ne paragrafin 2.4 nuk ka dhënë SQARIM BINDES për ta e pranuar si oferte përgjegjëse. Andaj sipas pikës 4 te nenit 61 te LPP konstatoj se oferta e Grupit te OE „MUHARREM HOTI B.I" & NTSh DELFINA MALISHEVË është ofertë JO NORMALISHTË E ULËT. Unë si ZPP refuzoj tenderin e Grupit te OE „MUHARREM HOTI B.I" & NTSh DELFINA MALISHEVË për arsye se janë plotësuar tri kushtet sipas formulës për tenderin jo normalisht të ulët.

Më tej shënohet: Grupi i OE ,"SMART PROJEKT" ShPK - "HIDRO PROJECT" ShPK & "GRAND BAU" ShPK shpërblehen me njoftimin për dhënie te kontratës për arsye se kanë ofruar tenderin e përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët në krahasim me ofertat tjera përgjegjëse.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ka dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit, rrjedhimisht ka interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Muharrem Hoti B.I.**

Sqarim hyrës

Parashtruesi i ankesës ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 08.08.2023, për të cilën AK me datë 10.08.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues dhe me tenderin e Grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së në lidhje me vendimin për eliminimin e OE ankues, përkatësisht arsyen e eliminimit që është çmimi jonormalisht i ulët i ofertës në tërësi dhe disa pozicioneve.

Rrethanat e çështjes

Sipas procesverbalit të hapjes së tenderëve dhe raportit të vlerësimit, janë dorëzuar katër oferta me çmimet si vijon:

- Grup i OE-ve "AS Tech SH.P.K".; NB COMPANY SH.P.K" me çmimin total të ofertës prej

133,402.50 euro.

- Grup i OE-ve "Muharrem Hoti B.I.; N.T.SH. Delfina" me çmimin total të ofertës prej 66,183.00 euro,

- OE "BAJRAM HA. GASHI B.I." me çmimin total të ofertës prej 128,093.00 euro dhe

- Grup i OE-ve "Smart Projekt SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K.; Grand Bau SH.P.K" me çmimin total të ofertës prej 112,655.00 euro.

Referuar njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 19.06.2023, AK ka vendosur që të refuzojë tenderin e OE ankues, me arsyetimin si në vijim: "[...] *1. Ne ofertën tuaj keni ofruar shume pozicione qe kanë çmim shumë te ulet. Lidhur me këto çmime ju kemi dërguar letër standarde për sqarim te tenderit duke u mbështetur ne nenin 61 të LPP. Kemi pranuar shkresën tuaj e cila sipas pikës se paragrafit 1 të nenit 61 deri ne paragrafin 2.4 të LPP nuk ka qene sqarim bindes për ta e pranuar si oferte përgjegjëse. Andaj sipas pikës 4 te nenit 6l te LPP oferta juaj është ofertë jo normalisht të ulët. Për tenderin jo normalisht të ulet janë plotësuar tri kushtet e cekura në nenin 41 paragrafi 41.3 pikat i, ii, iii të rregullores për prokurim publik.*

Me datë 08.08.2023 OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

Referuar vendimit të AK-së, datë 10.08.2023, rezulton, se AK ka nxjerrë vendim për refuzimin e ankesës e OE ankues, si vijon: "[...] *1. Vërtetohet Vendimi i AK Komuna Malishevës për dhënie të kontratës i datës 04.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe mirëmbajtja me material teknik për nevojat e institucioneve arsimore ne komunën e Malishevës, numër identifikues 62500-23-3176-1-1-1. AK- Komuna Malishevë vazhdon me tutje me procedurën e prokurimit. Andaj duke u bazuar nga ato që u thane me lartë dhe LPP nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, AK nuk ka bërë shkelje sipas pretendimeve të OE ankues andaj ka vendosur te refuzohet ankesa juaj si e pabazuar si dhe mbetet ne fuqi vendimi i AK lidhur me njoftimin për dhënie të kontratës*. Rrjedhimisht AK nuk ka arsyetuar vendimin e marrë ashtu sikurse kërkohet me nenin 108/A, paragrafi 9, ku thuhet "*Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj,parashtruesit të ankesës"* [...].

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se në bazë të çmimeve të ofertave janë plotësuar kriteret e pacaktuara me nenin 41.3 të RrPP për tu konsideruar si ofertë jo normalisht e ulët oferta e OE ankues. Më tej, sipas shkresave të lëndës AK ka zbatuar procedurën inter partes me OE ankues duke kërkuar sqarime me datë 29.05.2023, rrjedhimisht AK ka vepruar në pajtim me nenin 41 të RrPP duke ndjekur procedurën për sqarimin e çmimeve për tenderët jo normalisht të ulët. Sipas përgjigjes së OE ankues të dërguar tek AK me datë 29.05.2023, përveç konfirmimit të pajtueshmërisë me çmimet e ofertuara OE ankues nuk ka bërë ndonjë zbërthim të detajuar apo nuk ka dhënë arsyetim që përfshin një shpjegim për çmimin e ultë, mbi bazën e të cilit AK do të mund të bindej ashtu sikurse përcaktohet në nenin 41.6 dhe 41.8 të RrPP, rrjedhimisht AK nuk është bindur në lidhje me çmimet jo normalisht të ofertuara dhe ka vepruar sikurse përcaktohet me nenin 41.10 pika b). Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur ta rekomandoj për kontratë OE për shkak e i njëjti ka ofertuar me çmime manipulative përfshirë çmime jonormalisht të ulëta dhe të larta.

Rrethanat e çështjes

Në ofertën e dorëzuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë është dorëzuar edhe dokumenti i paramasës së çmimeve të ofertuara. Në pozicionin 49 Korrektor 1000 W, ku sipas paramasës së AK janë kërkuar 8 copë, çmimi i ofertuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë është 30 euro.

Gjatë krahasimit me çmimet e OE-ve tjerë që kanë dorëzuar tenderë në këtë aktivitet të prokurimit në bazë të kritereve të përcaktuara me nenin 41.3 të RrPP, janë plotësuar kushtet që çmimi në këtë pozicion është jonormalisht i ulët.

Sipas shkresave të lëndës AK nuk ka zbatuar procedurën inter partes me OE të rekomanduar për kontratë, që do të duhej ta bëjë sipas dispozitave të sipërpërmendura

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Sipas sqarimeve të mësipërme, OE i rekomanduar për kontratë në së paku një pozicion të identifikuar ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët, konkretisht çmimi i ofertuar (prej 30 euro për njësi) i plotëson kriteret e përcaktuara me RrPP dhe UPP për tu konsideruar jonormalisht i ulët, ndërsa AK nuk ka ndjekur procedurën inter partes, për dallim nga OE ankues, të cilit AK i ka kërkuar sqarime për pozicione të caktuara dhe tenderin në tërësi. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur ta rekomandoj për kontratë OE për shkak e i njëjti ka dështuar të ofrojë dëshmi për plotësimin e kërkesës 1 të kapacitetit teknik dhe profesional.

Rrethanat e çështjes

Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë të publikuar nga AK, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional është paraqitur kërkesa 1: *Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë në vlere prej 200,000.00Euro (dyqindëmijëeuro).* Për këtë kërkesë si dëshmi dokumentare është kërkuar*: a)Lista e kontratave - origjinal te natyrës se ngjashme ne 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate te bashkangjitura me kopjet proceseve, raporteve te pranimeve, referenca apo te ngjashme, ku identifikohet qartë shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj.) ose proceset e pranimeve nga OE privat, me kusht qe pagesat te janë kryer nëpërmes institucioneve bankare.*

Në formularin e çmimit të publikuar nga AK janë paraqitur 149 pozicione që përfshihen në këtë aktivitet të prokurimit. Këtu përfshihen furnizim me materiale elektrike, hidrosanitarisë, mjete të punës, materiale të ndryshme për ndërtim/meremetim dhe mjete të ndryshme për pastrim.

Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë ka prezantuar referenca dhe kontrata si vijon:

Listën e kontratave të Smart Projekt SH.P.K ku janë paraqitur 20 kontrata. Së bashku me listë të kontratave janë dorëzuar edhe dokumentet si vijon:

- Është dorëzuar kontrata e nënshkruar me datë 23.07.2021 ndërmjet AK-Komuna e Malishevës dhe Grup i OE-ve "Smart Projekt SH.P.K Prishtine; BURIM ZABELAJ; ALPING SH.P.K RAHOVICA COMERCE SH.P.K. & ATC COM SH.P.K." me titull të kontratës "Rregullimi i Kolektorit Kryesor Bellanice-Bubel- K. Malishevë", me numër të prokurimit 62500-21-3594-5-2-1, në vlerë prej 105 324,20 euro. Për të njëjtën kontratë është dorëzuar edhe referenca e lëshuar nga AK dhe raporti nga Komisioni i pranimit;

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar me datë 01.08.2019 ndërmjet AK-Komuna e Malishevës dhe Grupit të OE-ve "Smart Projekt Sh.p.k; Infra-Plus Sh.P.K." me titull të kontratës "Punimi i kanalizimeve nëpër fshatrat e Malishevës Loto 2", në vlerë prej 122. 796,25 euro. Poashtu është dorëzuar aneks kontrata e nënshkruar me datë 26.03.2023 për punë shtesë në vlerë prej 12,073.00 euro. Për të njëjtën kontratë dhe aneks kontratë është dorëzuar edhe referenca e lëshuar nga AK dhe raporti nga Komisionit të pranimit.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar me datë 09.08.2021 ndërmjet AK-Komuna e Malisheves dhe Operatori Ekonomik : "Smart Projekt SH.P.K" me titull "Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat e komunës së Malishevës: Carralluke, Vermice, Drenoc, Llazice, Mleqan, Bubavec, Balince, Kijeve, Plloqicë, Stapanice", me numër të prokurimit 62500-21-3549-5-1-1, në vlerë prej 148,711.51€. Poashtu është dorëzuar aneks kontrata e nënshkruar me date 25.11.2021 për punë shtesë në vlerë prej 14,844.24 euro. Për të njëjtën kontratë dhe aneks kontratë është dorëzuar edhe referenca e lëshuar nga AK dhe raporti nga Komisionit të pranimit.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar me datë 02.11.2020 ndërmjet AK-Komuna e Malisheves dhe Operatori Ekonomik : " Smart Projekt " SH.P.K me titull "Ndertimi kanalizimit i ujrave të zeza në Qytezën e Malishevës" me numër të prokurimit 62500.20.148.521 në vlerë prej 20,841.50€. Poashtu është dorëzuar aneks kontrata e nënshkruar me date 15.10.2021 për punë shtesë në vlerë prej 2,074.00 euro. Për të njëjtën kontratë dhe aneks kontratë është dorëzuar edhe referenca e lëshuar nga AK dhe raporti nga Komisionit të pranimit.

- është dorëzuar aneks-kontrata e nënshkruar me datë 25.03.2019 ndërmjet AK-Komuna e Malishevës dhe Grupit të OE-ve: "SMART PROJEKT" SH.P.K; N.N.P. ARHIKO – ING", me titull të kontratës "Punimi i kanalizimit neper fshatrat Banjë, Gajrak, Gurbardiie, Damanek dhe Malishevë" në vlerë prej 4,101.95 euro, në bazë të kontratës bazë të datës 11.10.2018 me numër 03/118.

Listën e kontratave të Grand Bau SH.P.K ku janë paraqitur 8 kontrata. Së bashku me listë të kontratave janë dorëzuar edhe dokumentet si vijon:

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar ndërmjet Grupit të OE-ve "Grand Bau SH.P.K & OE Hidro Project Sh.P.K" dhe AK-Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Korrektues të Kosovës me titull "Furnizim me material të hidrosanitarisë" në vlerë prej 47,638.70 €.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar në mes të Ndërmarrja Publike Banesore dhe Grupit të OE-ve "Grand Bau SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K," me titull të kontratës "Furnizim me material Ndërtimor dhe hekrari Lot 1" në vlerë prej 124,416.90 Euro. Poashtu është dorëzuar edhe referenca e lëshuar nga NPB me datë 16.07.2021 në lidhje me këtë kontratë.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar në mes të "Grand Bau SH.P.K" dhe "ENGRUP" për furnizim me material të ndryshëm e nënshkruar me datë 25.02.2020 me numër të kontratës 01-2020. Së bashku me kontratë janë dorëzuar 22 fatura për furnizim me material të ndryshëm. Gjithashtu janë dorëzuar edhe 20 dëshmi të pagesave përmes bankës.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar në mes të AK-Kuvendi Komunal Novobërde dhe Grupit të OE-ve "Grand Bau SH.P.K.; ENGRUP SH.P.K" me titull të kontratës "Furnizim me material ndërtimor" e nënshkruar me datë 11.06.2020. Poashtu është dorëzuar edhe referenca e lëshuar nga AK me datë 13.04.2021.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar në mes të "Grand Bau SH.P.K" dhe "ENGRUP" për furnizim me material të ndryshëm e nënshkruar me datë 15.03.2021 me numër të kontratës 02-2021. Së bashku me kontratë janë dorëzuar 41 fatura për furnizim me material të ndryshëm. Gjithashtu janë dorëzuar edhe 24 dëshmi të pagesave përmes bankës

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar në mes të KEDS dhe "Grand Bau SH.P.K" me datë

13.10.2022 me titull "Furnizim me material për mirëmbajtje LOT 2", në vlerë prej 6,659.51 euro. Poashtu është dorëzuar edhe referenca për këtë kontratë e lëshuar nga KEDS me datë 14.02.2023.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar në mes të KEDS dhe "Grand Bau SH.P.K" me datë 13.10.2022 me titull "Furnizim me material për mirëmbajtje LOT 3", në vlerë prej 2,870,35 euro. Poashtu është dorëzuar edhe referenca për këtë kontratë e lëshuar nga KEDS me datë 14.02.2023.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar në mes të "Grand Bau SH.P.K" dhe "ENGRUP" për furnizim me material të ndryshëm e nënshkruar me datë 31.01.2022 me numër të kontratës 01-2021. Së bashku me kontratë janë dorëzuar 38 fatura për furnizim me material të ndryshëm. Gjithashtu janë dorëzuar edhe 16 dëshmi të pagesave përmes bankës.

Listën e kontratave të OE "Hidro Project Sh.P.K" ku janë paraqitur 79 kontrata, megjithatë nuk janë dorëzuar dëshmi shtesë me listën e kontratave.

Me datë 12.06.2023, AK përmes letrës standarde për sqarimin e tenderëve kishte kërkuar nga OE "Smart Projekt SH.P.K" sqarime në lidhje me kontratat e anëtarit të grupit "Hidro Project SH.P.K."

Me datë 14.06.2023 OE "Smart Projekt SH.P.K" ka dorëzuar një dokument sqarues dhe kontratat për anëtarin e grupit "Hidro Project SH.P.K." si dhe kontratat për anëtarin e grupit "Grand Bau SH.P.K" si vijon:

- Kontratë me titull "Ndertimi i Sistemit te Ujesjellesit për 6 (gjashtë) fshatrat e Komunës së Lipjanit" nënshkruar me datë 25.03.2020 në mes të Community Development Initiatives (CDI) dhe "Hidro Project SH.P.K." & "ENGRUP "SH.P.K" në vlerë prej 769.620,26 euro. Është dorëzuar edhe referenca për këtë kontratë e lëshuar me datë 20.06.2022.

- është dorëzuar kontratë e nënshkruar me datë 08.10.2020 ndërmjet AK-Komuna e Malishevës dhe OE "Hidro Project SH.P.K" me titull "Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatin Astrazup në Komunën e Malishevës", me numër të prokurimit 62500-20-092-521, në vlerë prej 207,425.30€ €. Poashtu është dorëzuar aneks kontrata e nënshkruar me date 25.11.2021 për punë shtesë në vlerë prej 14,844.24 euro. Për të njëjtën kontratë dhe aneks

kontratë është dorëzuar dhe raporti nga Komisionit të pranimit.

- është dorëzuar kontrata e nënshkruar me datë 02.10.2019 ndërmjet AK-Komuna e Malisheves dhe OE " Hidro Project SH.P.K" me titull "Renovimi i objektit të administratës se komunës se Malishevës", me numër të prokurimit 62500.19.136.521, në vlerë prej 87,479.53€. Për të njëjtën kontratë përfshirë aneks kontratën është dorëzuar dhe raporti nga Komisioni i pranimit.

Në lidhje me formulimin kontrata të ngjashme, KRPP ka dhënë opinionin numër 11 me datë 09.06.2023 si vijon: "*Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë: OPINION: Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj. Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme. Në kuptim të prokurimit publik: Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës. Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Shembull: Lënda e Kontratës "Furnizim me mollë". Nëse AK kërkon si dëshmi " Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro". Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së). Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme". Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes*

me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në që rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik."

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Eksperti shqyrtues sqaron se llojet e produkteve që parashihet të prokurohen përmes këtij aktiviteti të prokurimit janë të ndryshme, duke përfshirë: material elektrik, hidrosanitari, mjete apo vegla pune, materiale të ndryshme për ndërtim/meremetim si dhe bazë, llaqe dhe ngjyra. Andaj, duke u bazuar në dëshmitë e dorëzuara me ofertë dhe sqarime pas kërkesës së AK-së, janë dorëzuar dëshmi bindëse që dëshmohet plotësimi i kërkesës për kontrata me material të ngjashëm. Kjo për faktin se të tre anëtarët e grupit kanë kontrata dhe fatura që përfshijnë furnizimin me lëndë sikurse janë: material elektrik, hidrosanitari, gypa të ndryshëm, shkuma, baza, llaqe, ngjyra të cilat si furnizime tejkalojnë vlerën prej 200,000.00 eurove. Andaj, bazuar edhe në opinionin e KRPP-së, ku thuhet se është kompetencë ekskluzive e AK-së të përcaktojë se çka përfshihet në furnizime të ngjashme, eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor në këtë pike është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Muharrem Hoti B.I.**

Kreshnik Spahiu